



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË

RREGULLORE PËR NGARKESA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE - 2011




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË SKUPŠTINA OPŠTINE-MALISHEVO

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 25.03.2011

PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 02/79



Malishevë, janar 2011

Në pajtim me nenin 12 dhe nenin 24.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal;

si dhe duke u mbështetur në nenin 12 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur, më 23.03.2011, miratoi këtë

RREGULLORE PËR NGARKESA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret për obliguesit, mënyra e llogaritjes, lartësia e tarifave, afatet e pagesës, arkëtimi, evidentimi dhe mbikqyrja e ngarkesave, dispozitat ndëshkuese dhe ankesat në ngarkesat e caktuara në bazë të kësaj Rregulloreje.

Neni 2.

Bartës të obligimeve si ngarkesa që përcaktohen më këtë Rregullore janë personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Malishevës, si:

- 2.1 Personat të cilët paraqesin kërkesë për vërtetime, certifikata të ndryshme, deklarata dhe parashtrësia tjera para organeve të Administratës komunale;
- 2.2 Personat fizik dhe juridik, të cilët bëjnë kërkesa për marrjen e lejeve (licencave) të bizneseve, ushtrimit e punës profesionale, leje tjera specifike për ushtrimit e veprimtarisë fitimprurëse në territorin e Komunës së Malishevës;
- 2.3 Personat të cilët bëjnë bartjen e të drejtës së pronës përmes transaksioneve;
- 2.4 Personat fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale apo kolektive për banim dhe afarizëm;
- 2.5 Personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, leje ndërtimore etj;
- 2.6 Personat që kërkojnë ndërrimet e destinimeve të parcelave të tokës;
- 2.7 Personat dhe subjektet, të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës për ndërtim apo pa ndërtim;
- 2.8 Personat apo subjektet, të cilët kërkojnë shërbime të kadastrit dhe gjeodezisë;
- 2.9 Subjektet të cilët merren me shfrytëzimin e resurseve natyrore;
- 2.10 Personat apo subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznes, tregje, parkingje, ekspozim publik të vitrinave reklamuese, lojëra argëtuese etj.;

Neni 3.

Lartësia e shumëve për shërbimet komunale të dhënies së certifikatës, vërtetimit, lejes për punë (licencës), lejes për ndërtim, rentës, kompenzimet e inspektimeve, dhe pagesa tjera përcaktohen me tarifa përkatëse që janë pjesë e kësaj Rregulloreje.

Neni 4.

Tarifat e ngarkesave janë shuma fikse, ndërkaq llogaritja (caktimi), dhe pagesa e tyre nga obliguesi bëhet me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e personave të ndryshëm.

- 4.1 Ngarkesat vjetore të caktuara për ushtrimin e veprimtarisë biznesore dhe tatimit në pronën e qytetarëve, paguhet në dy këste të barabarta dhe atë: kësti i parë gjerë më 15 qershor dhe kësti i dytë gjer më 15 dhjetor.
- 4.2 Ngarkesa vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit bëhet deri, më 30 prill të vitit në vijim, dhe më pas sipas paraqitjes së rasteve të regjistrimeve e hapjeve të reja të biznesit.
- 4.3 Kriteri i caktimit të ngarkesave vjetore për veprimtaritë biznesore (taksat komunale vjetore) është:
 1. Lloji i veprimtarisë që ushtrohet.
 2. Kriteri i zonës, si;
 - a) zona e I – Malisheva,
 - b) zona e II – Banja dhe Kijeva dhe
 - c) zona e III - të gjitha vendbanimet tjera në territorin e komunës.
 3. Kriteri i hapësirës;
 - a) hapësira afariste deri 100 m² , dhe
 - b) hapësira mbi 100 m². Kriteri e hapësirës zbatohet për veprimtaritë tregtare dhe shërbyese hoteliere.
- 4.4 Subjektet afariste, apo ndërmarrjet e të gjitha llojeve, të cilat e kanë selinë bazë në territorin e Komunës së Malishevës, ndërsa të njëjtën e ushtrojnë në vende të ndryshme në formë të njësive apo përfaqësive afariste në territorin e komunës, obligohen për secilën njësi punuese në shkallën 30% të tarifës bazë.
- 4.5 Ndërmarrjet të cilat në kuadrin e aktiviteteve të tyre afariste, nëpër njësi ushtrojnë veprimtari të llojeve të ndryshme, ngarkohen sipas tarifës për veprimtarinë e caktuar.
- 4.6 Ndërmarrjet të cilat selinë bazë e kanë në komunat tjera të Kosovës, e që në territorin e Komunës së Malishevës kanë të hapur njësitë apo përfaqësitë e tyre, ngarkohen me tarifën bazë të llojit të veprimtarisë.

Neni 5.

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat në afatet e caktuara me aktvendime të organeve të bankat në llogarinë përkatëse të komunës.

Neni 6.

Subjekti mund të bëjë ankesë ndaj Vendimit të lëshuar nga komuna, nëse konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij. Procedura e ankesës zhvillohet në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 126 e 127 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën administrative.

Neni 7.

Ndaj Vendimit të marrë nga komuna, pala mund të kërkojë të drejtën edhe në procedurë gjyqësore në pajtim me ligjet e zbatueshme në fuqi.

II. DISPOZITAT NDËSHKUESE

1. Drejtoria për Inspektorat

Neni 8.

Në rast të mospërmbushjes së obligimit gjatë afatit të caktuar, do të llogaritet kamata prej 1%, për ditët e vonesës ose 30%, për vit, por që shuma totale nuk do ta kalojë 150% të taksës së aplikuar.

Neni 9.

9.1. Nëse subjekti afarist edhe pas vërejtjes së dhënë për mos kryerje të obligimeve të taksës komunale në afat prej 7 (shtatë) ditësh, të lëshuar nga Drejtoria Inspektoratit, do të bëhet mbyllja e lokalit (veprimatrisë) afariste, deri sa të kryejë pagesën totale të taksave komunale.

9.2. Nëse pas mbylljes së lokalit (veprimatrisë) afariste, haste personi përgjegjës që e ka rihap kolain afarist pa lejen e organeve kompetente, do të konsiderohet se personi përgjegjës ka bërë kundërvajtje dhe rasti do të dërgohet në Gjykatën kompetente, ku personi përgjegjës do të dënohet për kundërvajtjen e bërë nga gjykata në shumën prej 1500-3000 €. Njëherit do t'i mbyllet përsëri veprimtaria (lokalit) afariste deri në pagesën totale të taksës komunale, ku pastaj do të jetë nën mbikqyrjen e përherëshme nga Drejtoria e Inspektoratit dhe Policia e Kosovës- Malishevë.

9.3. Gjatë kohës sa është lokalit i mbyllur, të gjitha dëmet eventuale të shkaktuara brenda lokalit, përgjegjësinë do ta bartë personi përgjegjës i subjektit afarist.

Neni 10.

Subjektet të cilat vendosin Panot reklamuese apo tabelat e ndryshme me qëllim reklamimi apo nxënie të hapsirave në trotuar, e të ngjashme ku pengohet qarkullimi nga personi zyrtar kompetent, do të dënohet me gjobë mandatore prej 20 €. Ndërsa, nëse edhe pas kësaj nuk evitohet pengesa do të dënohet përmes Gjykatës për kundërvajtje 200-300 €.

Neni 11.

Për tentim të mosdeklarimit të hapsirës së shfrytëzuar biznesore dhe mosparaqitjen e veprimtarisë tjetër që ushtrohet në kuadrin e atij subjekti, pronari apo personi përgjegjës, do të dënohet me gjobë madatore prej 50 €, kurse në procedurë kundërvajtëse përmes Gjykatës komunale për kundërvajtje, do të dënohet 300-500 €.

Neni 12.

12.1. Subjekti afarist, që edhe pas vërejtjes së lëshuar me shkrim për vonesë në regjistrim apo licencim të biznesit, në afat prej 30 ditësh haset pa Çertifikatë biznesi dhe Leje të punës, do të dënohet për kundërvajtje nga Gjykata kompetente;

- a) subjekti me statusin e ndërmarrjes 300 €;
- b) dyqani zejtar apo tregtar 200 €;
- c) tregtarët e imët 50 €.

12.2. Drejtoria për Inspektorat shqipton edhe këto gjoba mandatore:

- a) për transport të udhëtarëve me taksi pa Leje komunale të punës 50 €;
- b) për ekspozim të mallit në vende jo të destinuara 25 €;
- c) për keqpërdorim të ujit 25 €;
- ç) për hedhje të mbeturinave j one vendin e duhur 25 €.

Neni 13.

Personat fizik apo juridik, të cilët gjatë punëve ndërtimore kanë dëmtuar rrugët apo hapsirat tjera publike, janë të obliguar të evitojnë dëmin e shkaktuar menjëherë pas përfundimit të punimit, dhe jo më gjatë se 5 ditë, e nëse nuk e bëjnë këtë gjobiten sipas dëmit të shkaktuar.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14.

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është tabela e tarifave dhe ngarkesave që zbatohen nga drejtoritë komunale.

Neni 15.

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore pushon aplikimi i dispozitave në rregulloret dhe vendimet tjera lidhur me tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale që kanë qenë në fuqi gjer më tani, ndërsa dispozitat tjera që kanë të bëjnë me procedura dhe në rast se paraqiten mungesa juridike, do të mund të zbatohen ato.

- 15.1 Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë; Rregullorja mbi tatimin në pronë, Rregullorja për Ngarkesat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Neni 16.

Tabela e tarifave të kësaj Rregulloreje duhet të miratohet çdo vit gjer më 31 janar nga Kuvendi i Komunës, për të pasur fuqi të plotë dhe legale në grumbullimin e të hyrave për komunën gjatë viti në vijim.

- 16.1 Punët vjetore administrative të kryera nga drejtoritë komunale gjer me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, kanë vlerëshmëri të plotë, ashtu si janë vendosur me dispozitat e rregulloreve atëherë ekzistuese.
- 16.2 Me miratimin e kësaj Rregulloreje bie nga fuqi Rregullorja nr.01/306 e dt. 15.03.2010

Neni 17.

Kjo rregullore gjithëherë duhet të harmonizohet me ligjet dhe udhëzimet administrative të ofruara nga Qeveria e Kosovës për nivelin e komunave.

Neni 18.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

TABELA E TARIFAVE PËR TAKSAT DHE NGARKESAT KOMUNALE

Neni 19.

2. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

19.1. Tarifat e taksave administrative për dokumente;

1. Çertifikata e lindjes.....	1 €
2. Çertifikata e martesës.....	1 €
3. Çertifikata e vdekjes.....	1 €
4. Çertifikata e aktit të vdekjes.....	1 €
5. Çertifikata e vendbanimit.....	1 €
6. Çertifikata e personit që është në jetë.....	1 €
7. Çertifikata e mbajtësit të familjes.....	5 €
8. Çertifikata e shtesës për fëmijë.....	10 €
9. Çertifikata e shtetësisë.....	2 €

19.2. Tarifat e ngarkesave për shërbime tjera;

1. Të vërtetuarit autentik të dokumenteve (për faqe).....	1 €
2. Çertifikata në bazë të dëshmitarëve.....	1 €
3. Vërtetimi për papunësimin.....	1 €
4. Deklarata e bashkësisë familjare etj.....	5 €
5. Çertifikata e statusit martesor	10 €
6. Regjistrimi me vonesë në LAL (Libri Amzë i të Lindurve).....	2 €
7. Përkthimi dhe vërtetimi i dokumentit.....	3 €
8. Çertifikata e personit nën kujdestari.....	3 €
9. Vërtetim - sqarimi etj. (për nevoja jashtë vendit)	5 €
10. Anulimet, korrigjimet e gabimeve në LAL.....	5 €
11. Ndërrimi, përmirësimi i emrit dhe mbiemrit personal.....	5 €
12. Trifa administrative për dokumentet e marra nga vendet e huaja.....	5 €
13. Ceremonia e martesës gjatë orarit të punës.....	10 €
14. Ceremonia e martesës jashtë orarit të punës.....	15 €
15. Ceremonia e martesës jashtë ndërtesës.....	20 €
16. Zhvillimi i procedurës për vërtetimin e ekzistimit të martesës.....	25 €
17. Ceremonia e martesës me shtetësi tjetër.....	50 €
18. Pjesëmarrja në tender për dhënien e vijave për autobus dhe kombibus.....	10 €
19. Regjistrimet me vonesë në LAV.....	2 €
20. Ndërrimi i adresës, çlajmërimi i vendbanimit të qytetarit.....	1 €

19.3. Tarifa për mjetet juridike;

Kërkesa.....	1 €
--------------	-----

19.4. *Lirimi*

Nga taksat komunale administrative lirohen rastet e:

1. Asistencës sociale,
2. Familjet e ngushta të dëshmorëve, dhe
3. Invalidët e luftës.

Neni 20.

3. Drejtoria për Ekonomi , Financa dhe Buxhet

Tarifat e ngarkesave vjetore për veprimtaritë e biznesit;

Bujqësia, industria, ndërtimtaria

- 20.1 Kultivimi i kulturës së drithrave, pemëve dhe perimeve, hortikultura, rritja e bagëtive, shpendëve në ferma, gjuetia, peshkimi e të ngjashme, sipas sektorit A dhe B të klasifikimit standard të veprimtarive.
Tarifa vjetore 200 €
- 20.2 Eksploatimi në miniera i thëngjillit, zhavorit, rërës, gurit gëlqeror e xeheve tjera të ngjashme, sipas sektorit C të klasifikimit standard të veprimtarive.
Tarifa vjetore 600 €
- 20.3 Prodhimi, përpunimi dhe konzervimi i mishit dhe produkteve të mishit, e të ngjashme, sipas sektorit D të klasifikimit standard të veprimtarive.
Tarifa vjetore 300 €
- 20.4 Prodhimi i produkteve të qumështit, miellit, pijeve, duhanit e të ngjashme sipas, nënsektorit DA të klasifikimit standard të veprimtarive.
Tarifa vjetore 350 €
- 20.5 Prodhimet prej druri përveç mobileve, botimi i librave, riprodhimi i disqeve sonore, prodhimi i preparateve farmaceutike, parfumeve, sapuni dhe preparateve kozmetike e të toaletit, produkteve prej gome dhe plastike, prodhimi i produkteve të qelqit, pllakave prej qeramiks, prodhimve prej mermeri, tjegullave, tullave, prodhime me beton, prodhimi e metaleve dhe produkteve, dritareve, portave metalike dhe nga plastika, prodhimi i makinave dhe pajisjeve e të ngjashme, sipas nënsektoreve DB, DC, DD, DE, DF, DG, DH, DI, DJ, DK, DL, DM të klasifikimit standard të veprimtarive.
Tarifa vjetore 400 €
- 20.6 Prodhimi i tekstilit, lëkurës, betonit dhe asfaltit e të ngjashme në uzina e prodhime tjera, sipas nënsektorit DN të klasifikimit standard të veprimtarive.
Tarifa vjetore 600 €
- 20.7 Rikuperimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike dhe jometalike.
Tarifa vjetore 250 €

- 20.8 Furnizimi me gas e të ngjashme, sipas sektorit E të klasifikimit standard të Veprimtarive:
- | | |
|---------------|----------------------|
| a) me pakicë | Tarifa vjetore 300 € |
| b) me shumicë | Tarifa vjetore 600 € |
- 20.9 Ndërtimi i lartë, ndërtimi i rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit, objekteve sportive, tarsave lumore e të ngjashme, sipas sektorit F të klasifikimit standard të veprimtarive.
- Tarifa vjetore 1000 €
- 20.10 Ndërtimi i ulët, lyerja, meremtimi i objekteve dhe pjesëve të tyre, vendosja e instalimeve dhe pajisjeve e të ngjashme, sipas sektorit F të klasifikimit standard të veprimtarive.
- Tarifa vjetore 300 €

Neni 21.

Tregtia

- 21.1 a) Ndërmjetësimi në tregtinë me shumicë të automjeteve motorike, makinave, pajisjeve, apartave, tekstilit, porcelonit dhe produkteve të tjera përveç tregtisë së makinave bujqësore, farërave, plehrave, barërave mjekësore dhe mallrave ushqimore.
- Tarifa vjetore 800 €
- b) Tregtia me pakicë sipas pikës 1.
- Tarifa vjetore 400 €
- 21.2 Tregtia me pakicë e materialit ndërtimor dhe drurit, e plehrave dhe farërave.
- Tarifa vjetore 350 €
- 21.3 Tregtia jo e specializuar me shumicë e ushqimit, pijeve dhe duhanit
- Tarifa vjetore 500 €
- 21.4 Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara ku shiten artikujt ushqimorë, pijet dhe duhani;
- Zona e parë
- | | |
|--|--------------------------------------|
| a) hapësira deri 100 m ² | Tarifa vjetore 250 € |
| b) për hapësirën mbi 100 m ² ngarkesës bazë i shtohet | Tarifa për çdo m ² 0.50 € |
- Zona e dytë
- | | |
|--|--------------------------------------|
| c) hapësira deri 100 m ² | Tarifa vjetore 150 € |
| d) për hapësirën mbi 100 m ² ngarkesës bazë i shtohet | Tarifa për çdo m ² 0.50 € |
- Zona e tretë
- | | |
|--|--------------------------------------|
| e) hapësira deri 100 m ² | Tarifa vjetore 100 € |
| f) për hapësirën mbi 100 m ² ngarkesës bazë i shtohet | Tarifa për çdo m ² 0.50 € |
- 21.5 Tregtia në qarkullimin e barërave mjekësore me pakicë:
- | | |
|-----------------|----------------------|
| a) zona e parë | Tarifa vjetore 300 € |
| b) zona e dytë | Tarifa vjetore 200 € |
| c) zona e tretë | Tarifa vjetore 150 € |
- 21.6 Tregtia me pakicë e preparative bujqësore, preparative kozmetike, pijeve alkoolike e joalkoolike, e veshjeve (butiqet, sallonet e nuserisë) etj:
- | | |
|-----------------|----------------------|
| a) zona e parë | Tarifa vjetore 300 € |
| b) zona e dytë | Tarifa vjetore 200 € |
| c) zona e tretë | Tarifa vjetore 150 € |

d) për sipërfaqen mbi 100 m² në tri zonat ngarkesës bazë i shtohet

Tarifa për çdo m² 0.50 €

21.7 Tregtia me pakicë e tekstilit dhe tepihave:

a) zona e parë

Tarifa vjetore 300 €

b) zona e dytë

Tarifa vjetore 200 €

c) zona e tretë

Tarifa vjetore 100 €

d) për sipërfaqen mbi 100 m² në tri zonat ngarkesës bazë i shtohet

Tarifa për çdo m² 0.50 €

21.8 Tregtia me pakicë e mobilieve e orendive shtëpiake:

a) zona e parë

Tarifa vjetore 400 €

b) zona e dytë

Tarifa vjetore 250 €

c) zona e tretë

Tarifa vjetore 150 €

d) për sipërfaqen mbi 100 m² në tri zonat ngarkesës bazë i shtohet

Tarifa për çdo m² 0.50 €

21.9 Tregtia me pakicë e apartaave elektrike, shtëpiake, radioaparateve dhe aparateve TV, pjesëve për makina dhe autopjesë:

a) zona e parë

Tarifa vjetore 300 €

b) zona e dytë

Tarifa vjetore 200 €

c) zona e tretë

Tarifa vjetore 150 €

d) për sipërfaqen mbi 100 m² në tri zonat ngarkesës bazë i shtohet

Tarifa për çdo m² 0.50 €

21.10 Tregtia me pakicë e karburanteve dhe derivative të naftës:

a) në rrugët rajonale,

Tarifa vjetore 600 €

b) në fshatra.

Tarifa vjetore 400 €

c) për Opompat e derivateve që furnizojnë edhe me gas, tarifës bazë i shtohet edhe

Tarifa vjetore 100 €

21.11 Tregjet javore:

a) tregjet për automjete;

Tarifa vjetore 1000 €

b) tregjet e gjelbërta;

Tarifa vjetore 400 €

c) tregjet e plaçkave;

Tarifa vjetore 350 €

d) tregjet e kafshëve;

Tarifa vjetore 300 €

21.12 Tregtia me pakicë e produkteve tjera në dyqane të specializuara (këpucëve, libraritë, CD shopet e të ngjashme):

a) zona e parë

Tarifa vjetore 200 €

b) zona e dytë

Tarifa vjetore 150 €

c) zona e tretë

Tarifa vjetore 100 €

d) për sipërfaqen mbi 100 m² në tri zonat ngarkesës bazë i shtohet

Tarifa për çdo m² 0.50 €

21.13 Tregtia me pakicë e gjërave dhe sendeve të ndryshme të imëta në kiosqe:

a) zona e parë

Tarifa vjetore 100 €

b) zona e dytë

Tarifa vjetore 80 €

c) zona e tretë

Tarifa vjetore 60 €

Hotelet dhe restorantet

22.1	Hotelet dhe motelet me restorant;	Tarifa vjetore	800 €
22.2	Lokalet e natës;	Tarifa vjetore	500 €
22.3	Restorantet	Tarifa vjetore	300 €
22.4	Te hotelet dhe restorantet për sipërfaqen mbi 100 m ² në tri zonat ngarkesës bazë i shtohet	Tarifa për çdo m ²	0.50 €
22.5	Kafiteritë, ëmbëltoret diskoklubet;	Tarifa vjetore	200 €
22.6	Për sipërfaqen mbi 100 m ² ngarkesës bazë i shtohet	Tarifa për çdo m ²	0.50 €
22.7	Menzat dhe kuzhinat (gjellëtoret, hamburgerët etj.);	Tarifa vjetore	200 €
22.8	Për sipërfaqen mbi 100 m ² ngarkesës bazë i shtohet	Tarifa për çdo m ²	0.50 €
22.9	Çajtoret;	Tarifa vjetore	100 €

Neni 23.

Transporti tokësor

23.1	Transporti i rregullt i udhëtarëve;		
	a) deri tre (3) autobus	Tarifa vjetore	300 €
	b) mbi tre, për çdo autobusë tjetër	Tarifa vjetore	100 €
23.2	Shërbimet me taksi:		
	a) autotaksi	Tarifa vjetore	70 €
	b) kombibusët	Tarifa vjetore	100 €
	c) kompania e taksive për çdo automjet tjetër	Tarifa vjetore	30 €
23.3	Transporti i mallrave, rërës dhe materialeve tjera për ndërtim:		
	a) me maune	Tarifa vjetore	300 €
	b) me një automjet (kamion)	Tarifa vjetore	200 €
	c) ndërmarrja transportuese për çdo automjet tjetër	Tarifa vjetore	100 €

Neni 24.

Veprimtaritë përcjellëse dhe ndihmëse

24.1	Shërbimet bankare monetare dhe kredituese;	Tarifa vjetore	1500 €
24.2	Shërbimet e ndërmjetësimit financiar	Tarifa vjetore	800 €
24.3	Shërbimet e komunikimit postal dhe telefonik;	Tarifa vjetore	1500 €
24.4	Shërbimet telefonike private;	Tarifa vjetore	300 €
24.5	Kontrollimi dhe analizat teknike;	Tarifa vjetore	500 €
24.6	Veprimtaritë e fotografisë;	Tarifa vjetore	300 €
24.7	Ndërmarrjet e pastrimit të qytetit, pastrimin e objekteve, ndërmarrjet e ujësjellësit, pyjore, banesore	Tarifa vjetore	500 €
24.8	Veprimtaritë e agjencioneve të udhëtimit dhe shërbimet tjera për turistë, veprimtaritë e sigurimit të pasurisë dhe personave, parkingjet e automjeteve.	Tarifa vjetore	300 €

24.9	Shërbimet e fitnesit, tërenet për sporte (sallat) e të ngjashme	Tarifa vjetore	150 €
24.10	Organizimet e lojrave argëtuese, të fatit, bastoret, lodrave të ndryshme automatike sezonale në terrene të hapura që sjellin fitim e të ngjashme.	Tarifa vjetore	300 €
24.11	Shërbimet e internetit, bilardot e lojra të ngjashme;	Tarifa vjetore	200 €
24.12	Dhënia me qira e makinave, aparteve, skeleve, puna sezonale me makina bujqësore, kombajnerët e të ngjashme, pastrimi kimik i rrobave (tekstileve), fotokopjet dhe veprimtari tjera shërbyese të pa përcaktuara.	Tarifa vjetore	150 €

Neni 25.

Arsimi

25.1	Organizimi i kurseve të gjuhëve, kompjuterit, kurseve plotësuese për aftësim në lëndët e ndryshme, arsimimin e të rriturve me pagesë e të ngjashme;	Tarifa vjetore	150 €
25.2	Veprimtaritë e shkollave për shofer.	Tarifa vjetore	300 €

Neni 26.

Veprimtaritë profesionale dhe mbrojtja shëndetsore

26.1	Avokatët;	Tarifa vjetore	250 €
26.2	Konsultantët financiar (kotabilistët);	Tarifa vjetore	200 €
26.3	Stacionet lokale të radios;	Tarifa vjetore	150 €
26.4	Stacionet lokale me TV;	Tarifa vjetore	250 €
26.5	a) poliklinikat,	Tarifa vjetore	500 €
	b) qendrat diagnostike.	Tarifa vjetore	300 €
26.6	Shërbimet specialistike në ordinancë private.	Tarifa vjetore	200 €
26.7	Shërbimet specialistike private njëditore në javë	Tarifa vjetore	150 €

Neni 27.

Zejtaria

27.1	Frizerët për mashkuj, këpucëtarët, orëtarët, rrobaqepësit etj;		
	a) zona e parë	Tarifa vjetore	150 €
	b) zona e dytë	Tarifa vjetore	100 €
	c) zona e tretë	Tarifa vjetore	80 €
27.2	Vullkanizerët, autolarjet, mekanikët e rtv, elektromekanikët e apartave dhe pajisjeve të amvisnisë, autoelektricitë;	Tarifa vjetore	200 €
27.3	Sallonet e ondilimit për femra	Tarifa vjetore	300 €
27.4	Automekanikët, sallduesit ;	Tarifa vjetore	300 €
27.5	Artarët, argjendarët.	Tarifa vjetore	400 €
27.6	Furrëtarët, burekxhi	Tarifa vjetore	200 €

Neni 28.

Tarifat e ngarkesave komunale

- 28.1 Ngarkesa për transakcionet e pronës së paluajtshme (ndërtesa, toka, apartamente dhe struktura tjera) për çdo kontratë; Tarifa 100 €
- 28.2 Bartja e pronës familjare deri në shkallën e dytë të trashëgimisë dhe dhurata, për çdo kontratë; Tarifa 10 €
- 28.3 Në transakcionet e pronës së luejtshme, mjeteve motorike, Paguhet:
- a) për makina bujqësore, 10 €
 - b) për veturë, 20 €
 - c) për kamion deri në 3.5 t, 40 €
 - d) për kamion deri 25 t, 60 €
 - e) për autobus. 80 €
- 28.4 Ngarkesa për caktimin e vlerës qarkulluese të tregut nga ana e komisionit ad hoc në raste të transaksioneve të pronave dhe hipotekave;
- a) për parcelë Tarifa 20 €
 - b) për objekt Tarifa 40 €

Neni 29.

Renta për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale

- 29.1 Renta për eksploatimin dhe shfrytëzimin me gropim të pasurive tokësore e nëntokësore në pronësi të komunës: gurit, xheve, thëngjillit, zhavorit, rërës e të ngjashme për afarizëm; Tarifa vjetore për m³ 1.50 €
- 29.2 Shfrytëzimi i përkohshëm me ndërtime të forta për banim apo afarizëm; Tarifa vjetore për m² 2 €
- 29.3 Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike me vendosjen e kiosqeve, objekteve tjera prej montazhi në të cilat kryhet veprimtaria afariste:
- a) zona e pare, Tarifa vjetore për m² 1.50 €
 - b) zona e dytë, Tarifa vjetore për m² 1 €
- 29.4 Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për qëllime prodhuese industriale; Tarifa vjetore për m² 2 €
- 29.5 Shfrytëzimi i hapsirave në tregun e gjelbërt, të plaçkave, kafshëve e tregje tjera javore:
- a) për tavolinë shërbyese, Tarifa ditore 1 €
 - b) për automjet (veturë, kombi), Tarifa ditore 1.50 €
 - c) për kamion, Tarifa ditore 3 €
 - d) për kafshë të imta, Tarifa ditore 0.30 €
 - e) për kafshë të trasha. Tarifa ditore 0.50 €
- 29.6 Vendosja e standeve të hapura lëvizëse për shitjen e gjërave të imëta, aparateve për akulllore, kafe, pije

freskuese, librave jo shkollorë etj. të ngjashme; Tarifa ditore për m² 0.50 €

29.7 Ekspozimi i panove (pllakateve) reklamuese për biznes buzë rrugëve, në trotuare e hapësira tjera publike në qytezë (përveç atyre që janë të ngjitura në harmoni (linjë) me murin e objektit); Tarifa vjetore për reklamë (pano) 20 €

29.8 Vendosja e tavolinave shërbyese jashtë lokalit afarist; Tarifa mujore për tavolinë 2 €

29.9 Ngarkesa në marrjen e automjeteve në vendet e ndaluara nga komuna; Tarifa për çdo automjet 5 €

Neni 30.

4. Drejtoria për Urbanizëm

30.1 Tarifat e ngarkesave për ndërtim të objekteve;

1. Ndërtimi i shtëpive-banesave individuale dhe kolektive:

a) zona e parë	Tarifa për m ²	4 €
b) zona e dytë	Tarifa për m ²	2.5 €
c) zona e tretë	Tarifa për m ²	2 €

2. Nga kati i tretë e më lartë do të zbritet për 15% për çdo kat, por duke mos tejkaluar 60% për t'u liruar.

3. Aty ku lejojnë kushtet për mbindërtim vlejn të njëjtat tarifa.

4. Tarifa për bodrume dhe nënkulme kur përdoren:

a) për banim do të jetë 50% me e ulët nga tarifa e përcaktuar sipas zonave në pikën 1.
b) si objekte afariste, komerciale dhe industriale, zbatohen të njëjtat tarifa sipas zonave në pikën 1.

30.2 Ndërtimi i lokaleve afariste dhe komerciale:

a) zona e parë	Tarifa për m ²	12 €
b) zona e dytë	Tarifa për m ²	7.50 €
c) zona e tretë	Tarifa për m ²	4.50 €

30.3 Për objektet montazhe do të jetë 50% më e ulët.

30.4 Për shëndrrimin e banesave në lokale afariste paguhet diferenca e mbetur sipas zonave përkatëse, kur nga tarifa për lokale afariste dhe komerciale zbritet ajo e banesave.

30.5 Për ndërtimin në formë të magazinave (depove, silloseve) për llagerim dhe shitje të mallrave:

a) zona e parë	Tarifa për m ²	6 €
b) zona e dytë	Tarifa për m ²	3.5 €
c) zona e tretë	Tarifa për m ²	2.5 €

30.6 Tarifat e ngarkesave për objektet e pompave të karburanteve dhe deponive të gazit etj. të ngjashme:

a) për sipërfaqe të mbuluara	Tarifa për m ²	7.5 €
b) për sipërfaqe të hapura deri në 500 m ²	Tarifa për m ²	2 €

Neni 31.

5. Drejtoria për Gjeodozi dhe Kadastër

(Tarifat dhe ngarkesat janë të rregulluara dhe zbatohen në mënyrë unike sipas Udhëzimit Administrativ të Agjensionit Kadastral të Kosovës nr.AKK 2006/1.)

- 31.1 Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve (shitblerjes), dhuratës, dokumenteve administrative, trashëgimisë dhe ndarjes së pronës:
- | | |
|--|--------------------------|
| 1. për vlerën e transaksionit deri në 10 000 € | paguhet taksa prej 20 €, |
| 2. për vlerën e transaksionit prej 10 000 deri në 20 000 € | paguhet taksa prej 30 €, |
| 3. për vlerën e transaksionit prej 20 000 deri në 40 000 € | paguhet taksa prej 40 €, |
| 4. për vlerën e transaksionit prej 40 000 deri në 50 000 € | paguhet taksa prej 50 €, |
| 5. mbi vlerën e 50 000 €, për çdo 10 000 €, | paguhet vlera prej 10 €, |
- por shuma në e taksës së përgjithshme nuk mundet ta kalojë vlerën e 200 €.
- 31.2 Po që se vlera e kontratës-transaksionit është e pa vlerësueshme paguhet taksa - Tarifa në shumë prej 70 €.
- Në bazë të dhuratës*
- 31.3 Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme është e caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës së përcaktuar me nenin 31.1 (pikat 1, 2, 3, 4, 5).
- 31.4 Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme nuk është caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet taksa – Tarifa në shumë prej 40 € për çdo pronar – posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.
- Në bazë të dokumenteve administrative dhe gjyqësore*
- 31.5 Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme, e cila fitohet në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën – Tarifën në shumë prej 80 €.
- Në bazë të pjestimit (ndarjes) së pronës*
- 31.6 Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjestimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi bëhet duke paguar për secilin person pronarë – posedues Tarifën në shumë prej 20 €
- Në bazë të trashëgimisë*
- 31.7 Regjistrimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë bëhet, duke paguar për çdo trashëgimtar Tarifën në shumë prej 20 €
- 31.8 Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare, bëhet duke paguar për çdo anëtar të bashkësisë familjare që bëhet pronarë-posedues Tarifën në shumë prej 20 €

Në bazë të ndërrimit të pronës

- 31.9 Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar për secilin pronarë – posedues.

Tarifën në shumë prej 50 €

Regjistrimi i hipotekave

- 31.10 Regjistrimi i hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuara me dokumentin e hipotekës dhe atë:
- a) kërkesa (kredia) në vlerën deri 5 000 €, paguhet taksa- Tarifa në shumë prej 20 €,
 - b) kërkesa (kredia) në vlerën prej 5 000 € deri 10 000 €, paguhet taksa- Tarifa në shumë prej 30 €,
 - c) kërkesa (kredia) në vlerën prej 10 000 € deri 20 000 €, paguhet taksa- Tarifa në shumë prej 50 €,
 - d) kërkesa (kredia) në vlerën prej 20 000 € deri 40 000 €, paguhet taksa- Tarifa në shumë prej 70 €,
 - e) mbi vlerën 40 000 €, për çdo 10 000 € tekjkalim paguhen edhe nga 20 €, por shuma e taksës nuk mund t'a kalojë vlerën e 300 €.

Fshirja e hipotekave

- 31.11 Për vendimin lidhur me fshirjen e hipotekës nga regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme, duhet paguar taksa- Tarifa në shumë prej 20 €.

Regjistrimi i servituteve

- 31.12 Regjistrimi i të drejtës së servitutit në regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme bëhet duke paguar Tarifën në shumë prej 40 €.
- 31.13 Fshirja e servitutit nga regjistri bëhet duke paguar Tarifën në shumë prej 20 €.

Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtja

- 31.14 E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje prej 3 deri në 10 vjet mund të regjistrohet duke paguar Tarifën në shumë prej 30 €.
- 31.15 E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje prej 10 deri në 25 vjetësh mund të regjistrohet, duke paguar Tarifën në shumë prej 80 €.
- 31.16 E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje deri në 99 vjet mund të regjistrohet, duke paguar Tarifën në shumë prej 200 €.
- 31.17 Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes bëhet duke paguar gjysmën e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit.

Regjistrimi i përçojave dhe të drejtave tjera

- 31.18 Regjistrimi i përçojave do të bëhet, duke paguar për metër gjatësie (gjatësia e përçojës do të konfirmohet nga projekti) Tarifën në shumë prej 0.15 €
- 31.19 Regjistrimi i të drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme, e të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e kësaj Rregulloreje do të regjistrohen duke paguar Tarifën në shumë prej 40 €.

Tarifat e shërbimeve komunale kadastrale

- 31.20 Ndërrimi i kulturave kadastrale:
- a) ndërrimi i kulturës në një ngastër pa matje, 10 €
 - b) për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të, 5 €
 - c) ndërrimi i kulturës në një ngastër me matje, 35 €

d) për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të. 20 €
Në fund palës i lëshohet vendimi.

31.21 Ndarja e ngastrave:

- a) ndarja e një ngastre në dy pjesë me sipërfaqe deri 0.50 ha, 50 €
 - b) ndarja e një ngastre në dy pjesë me sipërfaqe mbi 0.50 ha, 100 €
 - c) për çdo pjesë tjetër, 25 €
 - d) ndarja e ngastrës në pjesë të përcaktuara më parë, 100 €
 - e) ndarja në më tepër pjesë të përcaktuara më parë, për çdo pjesë tjetër, 35 €
 - f) ndarjen e një ngastre në dy pjesë me matje të pjesës së re dhe ripërtitje të kufijve, 100 €
 - g) për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të 25 €
- Ngastra e re regjistrohet në planin kadastral dhe regjistër.

31.22 Rilevimi i ndërtesave:

- a) ndërtesat individuale për një ndërtesë, 50 €
- b) për çdo objekt tjetër në të njëjtën ngastër, 20 €
- c) ndërtesat shumëkatëshe – për një ndërtesë, ekonomike, plan parcele, 100 €
- d) objektet më të vogla që i takojnë ndërtesës shumëkatëshe-për një objekt, 20 €
- e) ndërtesa në formë jo të rregullt (me më tepër se 4 pika)-për çdo pikë plus. 10 €

Palës i lëshohet vendimi, kopja e planit.

31.23 Përtëritja e kufijve të ngastrave:

- a) për ngastrën me sipërfaqe gjer 0.50 ha, 80 €
 - b) për ngastrën me sipërfaqe prej 0.50 ha gjer 1.00 ha, 80 €
 - c) për çdo ngastër tjetër që kufizohet me të plus, 50 €
 - d) për rrugë, hekurudhë, kanale në gjatësi gjer në 100 m, 150 €
 - e) për çdo meter gjatësi shtesë – edhe. 0.50 €
- Palës i lëshohet vendimi dhe skica në të cilën shifet përtëritja e kufijve.

31.24 Punët në matje sipas kërkesave të posaçme:

- a) bartja e planeve urbanistike në terren – për një ngastër, 80 €
- b) puna në zyrë për ndarje e ngastrës, sipas planeve urbanistike – për një gastër, 20 €
- c) shënimi i vijës së rregullacionit të rrugës – për një metër. 0.50 €

Shënimi i kufijve në terren me rastin e shpronësimit

31.25 Shënimi dhe matja e kufijve – për një metër gjatësi 0.80 €

31.26 Identifikimi i ngastrave dhe objektve kadastrale në zyrë:

- a) identifikimi i numrave të ngastrave dhe pronarëve për një ngastër, 10 €
 - b) për çdo ngastër plus, 5 €
 - c) identifikimi i një ngastre pa matje – për një ngastër, 30 €
 - d) identifikimi i një parcele - krahasimi i gjendjes së re me të vjetrën (në zyrë) 15 €
- Palës i lëshohet konstatimi i ZKK-së.

- 31.27 Punët tjera gjeodozike:
- a) përpilimi i skicave për strukturën e banesës – ndërtesës, 40 €
 - b) matja e gypave, përçuesve elektrik dhe përçojave tjera për një metër gjatësi. 0.80 €
- 31.28 Koordinatat (y, x,z) dhe përshkrimi i pozitës së pikave gjeodozike
- a) koordinatat, lartësia mbidetare, përshkrimi i pozitës, çmimi për një pike, 10 €
 - b) vendosja e një pike gjeodozike (stacion i lirë), 30 €
 - c) për çdo pikë tjetër edhe nga. 10 €
- 31.29 Kopja e planit kadastral me paraqitje vertikale:
- a) për planin në shkallë 1:500, 25 €
 - b) për planin në shkallë 1:1000, 30 €
 - c) për planin në shkallë 1:2500, 30 €
 - d) për planin në shkallë 1:5000, 25 €
- 31.30 Shërbimet administrative:
- a) lëshimi i fletave poseduese, për fletën e pare, 3 €
 - b) ndërsa për çdo fletë tjetër të fletës poseduese, 1 €
 - c) certifikata për një ekstrakt, 2 €
 - d) regjistrimi, ndrrimi (bartja) apo fshirja e poseduesit të ri apo të drejtave mbi paluajtshmëritë, 20 €
 - e) kopja e planit A4 për një kopje, 5 €
 - f) kopja e planit A3 për një kopje, 7 €
- 31.31 Punët tjera sipas kërkesave të palëve, të cilat nuk janë të përfshira në pikat e lartëshënuara:
- a) punët në zyrë për një lëndë, 10 €
 - b) punët në terren për një lëndë, 30 €
 - c) për punët në terren prej 15 nëntorit gjer më 15 mars çmimet janë më të larta për 25%,
 - d) për punët dhe shërbimet, që do kryhen në tokat pyjore çmimet do të jenë më të larta për 30%,
 - e) pala duhet të sigurojë transportin dhe punëtorët ndihmës, për kryerjen e punëve në terren. Nëse ZKK-ja e siguron transportin, çmimi për kilometër është, 0.50 €
 - f) pala duhet më parë të paguajë për shërbime apo produkte, nëse ZKK-ja kërkon një gjë të tillë.

31.32 Pagesat dhe shpenzimet e transportit do t'i paguhen komunës drejtëpërdrejtë.

Neni 32.

6. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

- 32.1 Kompenzimi për punën se Komisionit në vlerësimin e dëmit në pronën bujqësore, vreshta, male, varreza etj., Tarifa për një rast 10 €

32.2	Puna e komisionit në ndryshimin e destinacionit të tokës bujqësore,	Tarifa për parcelë	10 €
32.3	Çertifikata për proceduara bujqësore,	Tarifa	1 €
32.4	Ndrrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë (sipërfaqe) për ndërtim:		
	a) për klasët e tokës 1 – 4,	Tarifa për m ²	1 €
	b) për klasët e tokës 4 – 6,	Tarifa për m ²	0.70 €
	c) për klasët e tokës 6 – 8,	Tarifa për m ²	0.50 €

Neni 33.

7. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale

33.1	Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore në nivel parësor		
	1. ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë,		1 €
	2. ekzaminimi specialistik në QMF, QKMF, me udhëzim të mjekut të familjes,		2 €
	3. ekzaminimi specialistik në QMF, QKMF, pa udhëzim të mjekut të familjes,		4 €
	4. ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente,		6 €
	5. medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoret publike,		0.30 €
	6. ultrazëri standard,		2 €
	7. radiografia,		2 €
	8. EKG,		0.50 €
	9. analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina,		1 €
	10. analizat laboratorike (komplet),		3 €
	11. caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,		1 €
	12. audiogrami,		1 €
	13. shpërlajra e veshit,		1 €
	14. dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente,		1 €
	15. dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente,		1 €
	16. përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim (vetëm në vizitën e parë),		3 €
	17. trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor,		1 €
	18. certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve,		18 €
	19. certifikata e mjekut e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,		18 €
	20. dhënia e raportit mjekësor, vërtetimi apo dokumenti tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,		5 €
	21. ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive etj.- për një orë		25 €
33.2.	Bashkëpagesa për shërbimet stomatologjike të nivelit parësorë-QKMF dhe QMF		
	1. vizitë e parë stomatologjike,		1 €
	2. RTG i dhëmbit,		1.5 €
	3. mbushje e përherëshme me amalgamë,		4 €
	4. mbushje e përherëshme me kompozitë,		5 €
	5. shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë),		5 €

6. amputimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë),	6 €
7. extirpimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë),	6 €
8. amputimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë),	6 €
9. extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë),	6 €
10. terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë),	6 €
11. rindërtimi konzervativ i dhëmbit me mbushje të përherëshme,	6 €
12. revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës,	1 €
13. fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave,	1 €
14. vulosja e fisurave,	1 €
15. mënjanimi i depozitimeve të buta,	1 €
16. mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull),	3 €
17. kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmb),	1 €
18. nxjerrja e dhëmbit,	1.50 €
19. incizioni intra dhe ekstra oral,	1.50 €
20. heqja e kurorës me anë të prerjes,	1 €
21. riparimi i protezës (ngjitja).	1.50 €

Neni 34.

8. Drejtoria për Arsim dhe Edukim

34.1 Për provimet me korrespondencë kandidatët janë të obliguar të paguajnë

1. për paraqitje,	20 €
2. lënda me shkrim,	0.70 €
3. lënda pa shkrim,	0.50 €
4. provimi i diplomës,	15 €
5. diploma duplikatë,	5 €
6. dëftesa duplikatë,	2.5 €

34.2 Për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur vijuesit do të Paguajnë:

1. për regjistrim të vitit,	100 €
2. për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën,	30 €
3. për diplomë përfundimtare të shkollimit,	50 €
4. për praktikë profesionale,	50 €
5. për ndryshim të lëndëve deficitare,	10 €
6. lëndët me gojë.	8 €

Neni 35.

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtëse në trafik i takojnë komunës. Alokimi i mjeteve të inkasuara bëhet sipas dispozitave të rregullativës së thesarit. Mjetet e inkasuara mund të jenë si rrjedhojë e dënimeve mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të Gjykatës për kundërvajtje.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 02/79Dt. 25-03 2011